# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-445715**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rekord remitancash në 6 muaj, emigrantët ju dërguan familjeve rreth 621 milionë euro në gjysmën e parë të vitit |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/15/rekord-remitancash-ne-6-muaj-emigrantet-ju-derguan-familjeve-rreth-621-milione-euro-ne-gjysmen-e-pare-te-vitit/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 10:48:33 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 15 shtator 2026, 10:45:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 15 shtator 2026, 10:44:00 UTC → 15 shtator 2026, 10:46:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `ec93b863f62e5dd823c18244a6d2ef5e6de2a906fe1d3fe5e91188d0df09c898` |
| TEKSTI | `90131f39ff0543bd8cac6e3540f536b249a1d69d36e09cf6cdf68dc01c680912` |
| PAMJA | `3317cd0c80d0a0831eb00a664a0cba41633818d1552d57e119c2ee8adeb1cd94` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `ef53e58be643faba1edbc2b37ad5f726e33453df19822a844a7d2c567a0ae148` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `93a0feb7bb19154a540f480bce1eeee0b2224e0180d4198842f090d06654d15a` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/ef53e58be643faba1edbc2b37ad5f726e33453df19822a844a7d2c567a0ae148`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

EKONOMI TË FUNDIT

# Rekord remitancash në 6 muaj, emigrantët ju dërguan familjeve rreth 621 milionë euro në gjysmën e parë të vitit

15/09/2026 12:45



**Nevoja për të ardhura shtesë po bën që familjet shqiptare të mbështeten gjithnjë e më shumë te paratë që u dërgojnë të afërmit emigrantë.**

Në gjashtë muajt e parë të vitit, remitancat kanë arritur në një tjetër rekord, por vlera e tyre për ekonominë vendase po dobësohet më shumë, teksa euroja e dobët përballë lekut bën që e njëjta shumë në euro të këmbehet për më pak lekë në Shqipëri.

Në këtë realitet, emigrantët kanë dërguar 621.4 milionë euro në gjysmën e parë të vitit, 16.9% më shumë se një vit më parë. Vetëm në tremujorin e dytë, dërgesat arritën në 347 milionë euro, me një rritje prej rreth 24%.

Edhe shifra e gjashtëmujorit është më e larta e regjistruar në serinë e të dhënave që prej vitit 2008. Ndërsa në vetëm një vit, ekonomisë shqiptare i janë shtuar kështu 89 milionë euro më shumë nga remitancat.

Kjo rritje lidhet edhe me ndryshimin e hartës së emigracionit. Italia dhe Greqia vijojnë të kenë komunitetet më të mëdha shqiptare, por vitet e fundit emigrantët janë shpërndarë gjithnjë e më shumë drejt vendeve si Gjermania dhe Britania e Madhe, ku pagat më të larta krijojnë edhe më shumë mundësi për dërgesa drejt familjeve në Shqipëri.

Rritja e këtij viti vjen pas një tjetër rekordi të vendosur në vitin 2025. Gjatë gjithë vitit të kaluar, remitancat arritën në rreth 1.12 miliardë euro, duke kaluar për herë të parë ndjeshëm nivelin e 1 miliard eurove.

Megjithatë, forcimi i lekut ndaj euros vijon të zbehë një pjesë të efektit të këtyre dërgesave për familjet që i konvertojnë të ardhurat në monedhën vendase. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2026, euro ka vijuar tendencën rënëse ndaj lekut, duke kaluar nga një mesatare mujore prej rreth 96.6 lekësh në janar në rreth 94.8 lekë në qershor.

**Top Channel**

## Ekonomi »



Rekord parash nga emigrantët, 621 milionë euro në gjashtë muaj, por kursi i këmbimit ua zbeh vlerën

14/09 20:15



"Bashkitë të përthithin projekte", kreu i BERZH për Top Channel: Për integrimin Shqipëria duhet të zgjerojë projektet në nivel vendor



Taksat në naftë mbushin arkën e shtetit, më shumë para në buxhet nga shtrenjtimi, 1.7 miliardë lekë më tepër që nga marsi

## Kryesore



Gjykata e Lartë merr vendimin për Veliajn, kryebashkiaku mbetet në burg

11:06

Dosja "Revanshi"/ GJKKO shpall vendimin, 50 vite burg për Durim Bamin dhe gjashtë të pandehurit e tjerë

09:32

Cënuan perimetrin e sigurisë në shkolla gjatë tubimit të djeshëm, arrestohen 12 protestues, procedohen 15 të tjerë

10:39

Vuçiç zbulon datën e dorëheqjes, presidenti i Serbisë: Fushatën e vazhdoj si qytetar i thjeshtë

11:34

Ekskluzive/ Maran hap listën e madhe, rreth 50 ftesa për Kombëtaren, mes tyre 3 lojtarë të Dinamo City

09:50

## Më të lexuarat

Mbyllet gjyqi ndaj Thaçit në Hagë! Procesi për pengim të drejtësisë, mbrojtja kundërshtoi transkriptet e prokurorisë dhe kërkoi pafajësi

25 mijë euro vetëm pishina/ Email-et dhe dokumentet në dosje, SPAK ia atribuon vilën Belinda Ballukut. Heshtin "Atelier 4" dhe "Green Coast"

Gjykata e Lartë merr vendimin për Veliajn, kryebashkiaku mbetet në burg

Mbretëria e Bashkuar po dridhet/ Skocia, Uellsi dhe Irlanda e Veriut kërkojnë referendum: E ardhmja jonë është në BE

Tensionet zhvendosen në hapësirë, SHBA pranon se ka armë në orbitë: Rusia dhe Kina konsiderohen kërcënimet kryesore

"China Zorrilla", anija më e madhe elektrike në botë mbërrin në Uruguai, nis udhëtimet në tetor

"O kukull, projektligji për kinemanë do deformojë filmin duke futur video-lojëra", Mevlan Shanaj përballet live në 'Ftesë në 5" me drejtorin e QK, Jorgji: Po flitet keq për njerëz që punojnë

"FBI kishte mijëra përgjime për Al Caponen, por s'kishte prova", Filip Çakuli: Veliajn e arrestuan nga thashethemet, e linçuan publikisht

Nga një 'like' në Instagram te propaganda



serbe, si u shemb skandali i 'kushteve të këqija' në Tiranë

Pikë referimi për shqiptarët në Itali/ Inaugurimi i Konsullatës së Nderit të Shqipërisë, kryeministri Rama në Napoli për ceremoninë

13/09 18:45

13/09 12:29

Rekord investimesh të huaja/ 1.1 miliardë euro në gjashtë muaj, projekti i Zvërnecit shton flukset hyrëse
11/09 15:10

Program i ri për strehimin, Qeveria prezanton 6 skema për familjet e reja dhe shtresën e mesme, 4 mijë përfitues
10/09 19:58

Pagat rriten, punësimi bie/ Një në katër punonjës mbetet me rrogë minimale, thellohen diferencat në treg
10/09 15:12

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »

Top News – 'Pasqyra' mbërrin në Kuvend. Platforma me ligj të veçantë për ankesat e qytetarëve

Top Channel/ Përplasje për tenderat te "Xhafaj", Kaso: Kalohen me 99.9%, ofertuesit "vetëdigjen"

Top Channel/ Erion Veliaj mbetet në burg, Gjykata e Lartë rrëzoi kërkesën e avokatëve të tij

Top News – Armatimi ka dalë në hapësirë / SHBA pranon se ka armë në orbitën e tokës-Gati për sulm!

Top News- Vetë me pushime, 'punuan' asistentët/ Deputetët e Kosovës, 50 mijë euro për ndihmësat

Top Channel/ Ulen taksat mbi karburantet, RMV, Italia, Spanja dhe Qiproja lehtësojnë konsumatorët


**Lajme**
Lajmet e fundit
Politikë
Kronikë
Aktualitet
Ekonomi
Sociale
Video
Top News LIVE

**Bota**
Opinion
Koment
Kosova dhe Rajoni
Shkencë dhe Teknologji
Auto

**Sport**
Kombëtarja
Kategoria Superiore
Kategoria e Parë
Premier League
La Liga
Serie A
Shumësportësh
Sport Gossip

**Pop News**
Showbiz
Lifestyle
Fashion
Shëndeti
Dieta
Receta gatimi

**Programe**
Big Brother VIP
Për'puthen
Shqipëria LIVE
Fiks Fare
Video
Të gjitha programet
Guida TV

**Top Channel**
Rreth Top Channel
Bileta
Kontakt
Puno në Top Channel
Privacy Policy & Terms of Use
Aksesueshmëria


© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.